

Nexha t Maloku
Nexhunjë Mësimetaj


Për nivelin
e parë

PUNA DHE KOHA E LURË



duk²gjini





Nexhat Maloku, Nexhmije Mehmetaj

Puna dhe koha e lirë

Fletore tematike
për nivelin e parë

duk^ə_Dgjini

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS

TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis, Nexhat Maloku,
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues të këtij teksti: Nexhat Maloku, Nexhmije Mehmetaj

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Instituti IPE -International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.

PH Zürich



LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH

PËRMBAJTJA

1. Profesionet përreth nesh	4
2. Në dyqanet e qytetit	6
3. Ne vishemi e mbathemi	8
4. Ne fermën e Gjergjit	10
5. Në kohën e lirë	14
6. Mësimi i veçantë i Zanës	16
7. Ne luajmë me zar	18
8. Kësulëkuqja	20
9. Ne udhëtojmë për në vendlindje	22
10. Si e kalojnë kohën e lirë Zana dhe Iliri	24
11. Nora në autobus	26
12. Ëndërrat e fëmijëve	28
13. Fatosi në spital	32
14. Xhaxhi murator	34
15. Ndihmojmë prindërit	36
16. Në ekipin e futbollit	40
17. Në bibliotekën e qytetit	42
18. Para ekranit të televizorit	46
19. Vizitë në kopshtin zoologjik	50
20. Vizitë te daja	52
21. Video lojërat	54

1. Profesionet përreth nesh

1. Flasim.

Ja disa profesione. Thuaj emrat e tyre. Thuaj profesionin e prindërve të tu. Po ty a të pëlqen të bëhesh si ata? Çfarë pune bën ti në shtëpi?

2. Lexojmë.

Fjalët që tregojnë mjeshtëri, ndryshe i quajmë profesione.



bukëpjekësi



mekaniku



kozmonauti



flokтарja



postieri



bankierja



shkencëtarja



fermerja



shoferja



fotografi



kopshtarja



polici



muratorji



kameramani



bletarja



mjekja



veterinarja



infermierja



politikani



mësuesi

• Kuptojmë,

lidh fjalët sipas kuptimit! Kush? Çka? Ku?

- Bukëpjekësi
- Mekaniku
- Muratori
- Mjekja
- Kopshtarja
- Marinari
- Infermierja

- ndërton
- gatuan
- rregullon
- punon
- drejton
- shëron
- ndihmon

- bukë
- shtëpi
- vetura.
- kopsht
- njerez
- të sëmurit
- anijen

- furrë
- mistri
- kaçavidë
- lopatë
- barna
- busull
- injeksione

Unë jam _____

b.) Ajo me mendje dhe me libra
ty të mëson?

Cili është ky profesion?

Ajo është _____

c.) Ai është zemërmirë,

Ai ka veshur mantel të
bardhë.

Cili është profesioni i tij?

Ai është _____

ç.) Ne punojmë me gëershërë.

Qepim rroba me gjilpërë.

Cili është profesioni ynë?

Ne jemi _____

3. Shkruaj.

Çfarë dëshiron të bëhesh kur të rritesh? _____

4. Si thuhen këto fjale në gjuhën e vendit ku jeton?

mekanik _____

mjek _____

mësues _____







kopshtar _____

2.

Në dyqanet e qytetit

1. Të flasim.

Çka mund të blejmë në këto dyqane? Kush mund të blejë në dyqane? Cilat dyqane mund t'i përmendësh? Kur hyn në dyqan çka thua?



2. Lexojmë

Në dyqanet e qytetit

Qyteti ynë ka dyqane me mallra të ndryshme. Aty mund të blesh shumë gjëra që të duhen. Në dyqanin e parë mund të blejmë **bukë, ëmbëlsira**.

Në të dytin **mish, salsaçë...**

Në të tretin **qumësht, djathë...**

Në të katërtin **lapsa, ngjyra,**

Në të pestin **libra, kartolina,**

Në të gjashtin **pemë dhe perime.**

•Kuptojmë

Cilat janë dyqanet e qytetit sipas tregimit? Çka mund të blejmë aty?

A ke qenë ndonjëherë në dyqane? Çka ke kërkuar?

• **Analizojmë**


Në cilin dyqan shitet buka? _____

Në cilin dyqan shitet djathë dhe qumësh? _____

Ku mund të blejmë lapsa, fletore? _____

Çka blejmë në librari? _____

• **Thellohemı.** Çfarë gjërash mund të blejmë me këto qese? Vizato.



3. Shkruaj një tekst sipas ilustrimit: " Shitësja dhe blerësja"



4. Si thuhen këto fjalë në gjuhën e vendit ku ti jeton?

shitësja _____

blerësja _____

3. Ne veshim e mbathim


1. • Flasim për veshjet. Si vishemi ne? A mund të ndahen veshjet sipas kohës? Trego si vishemi kur është ftohtë, kur është vapë, kur bie shi, kur jemi në punë, kur luajmë, kur festojmë?



2. • Lexojmë tekstin "Ne veshim e mbathim"

Unë quhem Ilir.

Unë jam një djale nga Kosova.
Jam i biri i Agron Berishës.
Sot jam në festë.
Kam veshur këmishë e xhamadan
dhe tirq me gjatë të zinj.
Në kokë kam vënë plisin e bardhë.
Unë kam mbathur opinga.
Kështu visheshin dikur të parët tanë.
E dua shumë këngë shqipe.



• **Kuptojmë**

Për çka flet teksti "Ne veshim e mbathim"?

Djali i kujt është ai?

Prej nga është? Pse ka veshur ai kostumin kombëtar?

• **Analizojmë**

Çka mban Iliri në kokë?

Çka ka ai mbi këmishë?

Si quhen pantallonat që ka veshur Iliri?

Çka ka mbathur Iliri?

• **Thellohemë**

Si duket Iliri? Çka do ai?

3 • Të shkruajmë

• Shndërroje tekstin për Ilirin sipas shembullit.

Ai quhet _____


4. Si thuhen këto fjalë në gjuhën e vendit ku jeton?

pantallona _____ fustan _____

këpucë _____ çizme _____

4. Në fermën e Gjergjit

1. •Flasim. Vërej figurën. Trego çka sheh. Cilat kafshë jetojnë në fermë? Cilat shpezë mund të jetojnë në fermë?



2. •Lexojmë

Në fermën e Gjergjit

Unë quhem Gjergj Konaj.

Punoj në fermë së bashku me gruan time.

Jam 37-vjeçar.

Ne kemi 3 fëmijë.

Jetojmë në fshatin Tropojë të Shqipërisë.

Gjatë verës kemi shumë punë në ara dhe në stallë.

Unë mjet lopët, mbledh sanën, i çoj kuajt të kullosin në livadh.

Fermerja çdo ditë mbledh vezët, ushqen shpezët.

Nga qumështi i deleve dhe dhive ajo nxë djathë dhe mbledh mazë.

Në dimër e mirëmbaj traktorin.

•Kuptojmë

Për kë flitet në këtë tregim? Si quhen personazhet e tregimit?

Çka punojnë në verë e çka në dimër? Kur kanë më shumë punë?

•Analizojmë

Cilat punë i kryen fermeri?

Çka bën fermerja?

•Thellohemi









Çka bën fermeri gjatë dimrit?

Çka bëjnë me qumështin e dhive dhe të deleve?

Si quhet fermeri? Sa vjet ka ai? Sa fëmijë kanë ata?

3 Shkruajmë • Në çdo rresht fshij fjalën që është pa vend.

Shkruaj fjalët që i përkasin së njëjtës familje kafshësh.



4. Detyrë. Thoni emrat e kafshëve në gjuhën e vendit ku jetoni!



Kendojme :

RIK- RIK E VOGLA ROSE

Kjo këngë e bukur i kushtohet një rose të vogël që noton në lumin e bukur Vjosë në Shqipëri.

Mësoni ta këndoni me ndihmën e mësuesit /ses.

B. Mulliqi
A. Huruglica

Allegretto

Rik - rik - rik e vo - gla ro - së mos u laj ti sot në vjos' se

Vjo - sa qen - ka e ze-më - ru - ar ardh - ka shum' e tur - bu - llu - ar

va - lët du - an të të gë - njej - në dhe me ve - te të rrë - mbej - në.

Strofa e dyte:

Rik-rik-rik, e vogël rosë
mos u laj ti sot në vjosë
se vjosa qenka e zem'ruar
ardhka shum' e turbulluar
do të mbytesh s'të ndij dot
un' akoma nuk di not

5.

Në kohën e lirë

1. Të flasim

Vërej figurat dhe thuaj se si e kalojnë fëmijët kohën e lirë.

- Ç'bën në kohën e lirë? Qarko figurat e aktiviteteve që bën.



2. Të lexojmë

Në kohën e lirë

Iliri është nxënës i zellshëm. Ai bën gjithmonë detyrat në kohë të caktuar dhe në vend të njëjtë. Përveç librave shkollore, në kohë të lirë, lexon revista e gazeta për fëmijë.

Ai kënaqet kur lexon vjersha, tregime e përralla të ndryshme në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe në atë të vendit ku jeton tash. Iliri është i dalluar edhe në ekipin e futbollit.



• Kuptojmë

Për kë flitet në këtë tekst?

Si të duket ky djalë?

Çka bën ai në kohën e lirë?

Përshkruaje me fjalët e autorit aktivitetin e Ilirit?

• **Analizojmë**

A ke kohë të caktuar për pushim dhe argëtim? _____

Ku i bën ti detyrat e shtëpisë? _____

Kush të ndihmon për të bërë detyrat? _____

Çka bën gjatë kohës së lirë? _____

Afërsisht sa orë luan? _____

Sa orë lexon? _____

A ke orar të caktuar se kur mëson dhe

kur i bën detyrat e shtëpisë? _____

• **Thellohemi**

Ç'mendon ti, a duhet nxënësi të punojë gjithmonë me orar të caktuar?

Pse? _____

3. Të shkruajjmë.

Kthehu te fleta e parë.

Shkruaj nga një fjali për aktivitetin e fëmijëve sipas shembullit.

1. Ai shikon insekte _____

4. Detyrë: Si thuhen në gjuhën e vendit ku ti jeton për këto fjalë:



shikoj _____ luaj _____ lahem _____

6.

Mësimi i veçantë i Zanës

1 Flasim.

Çka paraqesin këto dy pamje? Ku janë këta nxënës? Thuaj se sa gjuhë flet. Si quhet gjuha që flisni në shtëpi dhe si quhet gjuha që mësoni në shkollë?



2. Lexojmë tregimin

(Zana tregon për një mësim të veçantë nga shkolla e vendit ku ajo jeton)

Mësimi i veçantë i Zanës

- Zana: Një ditë mësuesja solli një aparat në klasë.
Mësuesja: Të dashur nxënës, çka mund të ketë në ketë kuti?
Nxënësit: Ah! Është një kuti magjike...Dhe nuk bën ta hapim.
Mësuesja: E mirë. Ja, është një aparat që flet shumë gjuhë.
Luli: Si punon ky!
Albani: A flet edhe shqip?
Mësuesja: Po e provojmë: Ju duhet të flisni para mikrofonit. Pastaj, e shtypni pullën në të djathtë, për ta zgjedhur gjuhën që ju doni.
Luli: Asgjë nuk po kuptoj.
Mësuesja: Pritni pak. Po e përgatis aparatin. Ja, unë po them: Mirëdita, ju thoni në gjuhën që flisni në shtëpi.
Luli: Ah! E di. Aparati na ndihmon për të mësuar shumë gjuhë.
Mësuesja: Po. Dëgjoni fjalët që di aparati ynë : Bon jour! God Dag!



Mirëdita! Good morning! Bon gidrno!

Sa të gëzuar e ndien veten djemtë dhe vajzat e klasës kur dëgjuan zërin e tyre në magnetofon.

•Kuptojmë!

Për kë flitet në ketë tregim?

Kujt i tregon Zana për mësimin e veçantë?

Në sa shkolla shkon Zana?

Pse ishte kjo orë e veçantë për Zanën? Çfarë kishte sjellë mësuesja në kuti?

•Analizojmë

Si u ndien nxënësit kur dëgjuan fjalët në gjuhën e tyre?

Çfarë gjuhe flasin shokët dhe shoqet e Zanës?

Përse u shërbeu magnetofoni në klasë?

A u pëlqeu ky mësim?

•Thellohemi

Si flet ti në shtëpi dhe si flet në shkollë?

Trego sa gjuhë flet ti, cilat janë ato?

Si e ndien ti veten me dy gjuhë?

Cilat fjalë i dëgjuat nga magnetofoni?

3. Shkruaj disa fjali për shoqet dhe shokët e klasës. _____


4. Fjalitë që ke shkruar përkthej në gjuhën e vendit ku ti jeton. _____

7.

Ne luajmë me zar

1. Flasim.

Vërej figurën dhe trego çka bëjnë këta fëmijë? Ç'lojë luan më shumë? Më kë luan? Në ç'vend luan? Kur luan?



2. Lexojmë tekstin "Ne luajmë me zar". Vizato çfarë kuptove nga tregimi.

- Iliri:** Bujar, a luajmë së bashku?
Bujari: Mirë. Luajmë këtu pranë shkollës.
Iliri: Çfarë loje do të luajmë, Bujar?
Bujari: Luajmë me zar.
Teo: Më pëlqen të luaj me ty Ilir. Të lutem, më prano edhe mua në lojë?
Iliri: Mirë, Teo, eja të luajmë bashkë. Ti cakto vendin, bëj shenjën,
nga ku do t'ia fillojmë.
Bujari: Unë po thelloj gropën ku do ta hedhim zarin.
Iliri: Kush po fillon?
Teo: Zarin po e hedh unë i pari.
Iliri: Tash e kam radhën unë. Po e provoj.
Bujari: E hodhi me shkathtësi zarin dhe e qëlloi me të parën.

*Dy shokët e Bujarit e hodhën disa herë zarin, por ata asnijëherë
nuk arritin ta qëllonin zarin.*

Bujari çdo herë e fitoi lojën.

•Kuptojmë

A ju ka pëlqyer ky tregim? Pse? Si quhen tre personazhet e tregimit?

Trego kush e fitonte lojën? Kush humbte në lojë?

A luan ti ketë lojë? Me kë luan ti? A njeh ndonjë lojë tjetër përveç kësaj?

•Analizojmë

A luajmë _____? Çfarë loje do të _____.

Më pëlqen të luaj me _____. Ju lutem, më pranoni në _____

•Thellohemi.

Trego vetë si luhet loja me zar!

3. Shkruaj Çka ke mbajtur në mend nga leximi “Loja me zar”? _____

Vërej figurën dhe krijo tri ffjali me ffjalët e dhëna. Emrat e fëmijëve imagjinoji.

kacavaret luhatet fshihet



4. Si quhet “Loja me zar” në gjuhën ku ti jeton?

loja _____ zari _____

8. Kësulëkuqja

1 Të flasim. Shpjego me gojë përrallën “Kësulëkuqja”.

Kush është Kësulëkuqja?

Ku shkonte ajo? Me kë u takua ajo në pyll? Kush i ndihmoi ato?



2. Të lexojmë. “Kësulëkuqja”

Çdo ditë,
Kësulëkuqja i çonte ushqim gjyshes së vet.
Me një shportë të mbushur me dredhëza
Kësulëkuqja vraponte nëpër pyll.
Një ditë ajo takoi ujkun.
Ai i tha :“Ku shkon ti”?

•**Kuptojmë**

Plotësoni tekstin me fjalë të munguara.

Çdo ditë _____

i çonte ushqim _____ a _____.

Me një shportë të mbushur me _____

Kësulëkuqja _____ nëpër pyll.

Një ditë ajo takoi _____.

Ai i tha: _____

• **Analizojmë**

Vërej çdo vizatim dhe përgjigju pyetjeve me gojë.

3. Shkruajmë përgjigjen e pyetjeve.

1. Çka po bën Kësulëkuqja?

Ajo _____

2. Ku shkon ajo?

Ajo _____

1. Kush është ai?

Ai _____

2. Si është ai?

Ai _____

2. Ku shkojnë ata?

Ata _____

3. Çfarë mbajnë në shpinë ata?

Ata _____

• **Lidh fjalët sipas kuptimit:**

Kësulëkuqja • pushkë gjuetie

Gjyshja • i dendur

Ujku • i lig

Gjetari • e vogël

Pyll • e sëmurë

4. A e di si quhet "Kësulëkuqja" në gjuhën e vendit ku jeton ti?

Detyrë: Shkruaji këto fjalë në gjuhën e vendit ku jeton ti!

gjyshja _____ pylli _____

gjetari _____ ujku _____

9. Ne udhëtojmë për në vendlindje

1. • Flasim
- Si quhet vendlindja jote?
 - Kur dhe ku keni udhëtaruar ju me aeroplan?
 - Trego përshtypjet tuaja nga udhëtimi



2. Lexojmë.

“Ne udhëtojmë për në vendlindje”

Ne hymë në aeroport.
Babi mbante valixhet.
Mami tha: “Zana! Merre një karrocë!”
Në hyrje pritnin udhëtarët.
Nga lart vinte zëri i altoparlantit.
Një kontrollues i verifikonte biletat dhe pasaportat tonë.
Ne ngjiteshim në aeroplan. Zana dhe Iliri u ulën përpara.
Babi dhe mami u ulën prapa.
Aeroplani largohej me shpejtësi.
Toka nuk dukej më. Mbetëm shumë të kënaqur nga udhëtimi
për në Prishtinë.

• Kuptojmë

Për se flitet në ketë tekst?
Kush mbante valixhet?
Çfarë e porositi mami Zanën? Si përfundon ky tekst?

• **Analizojmë**

Sa është larg vendlindja jote nga vendi ku jeton ti tash?

Përafërsisht _____ km.

Sa orë zgjat udhëtimi?

Me aeroplan _____ orë. Me veturë _____ orë.

• **Thellohemë**

Me çka ne mund të udhëtojmë në vendlindje?

Vizato mjetet e udhëtimit dhe shkruaj emrat e tyre..

3. • Përshkruaj tekstin sipas modelit, duke shtuar pjesën "nuk" ose "s'"

Ne nuk hymë në aeroport.

Babi s'mbante valixhet.

4. Detyrë. Cilat ushqime të vendlindjes nuk i gjeni në vendin ku jetoni? Vizato

10.

Si e kalojnë kohën Zana dhe Iliri?

1. Flasim.

Vërej figurat, thuaj çka paraqesin këto dy pamje.
Çka bën ti në kohën e lirë? A e di ti për se na shërben kompjuteri?
A komunikon ti përmes internetit?

Tungjatjeta, Ilir!
A i bëjmë detyrat e shtëpisë?
Unë po i shkruaj përshëndetjet.

Tungjatjeta, Zana!
Mirë!
Unë i plotësoj ato.



2. Lexojmë. Përshëndetjet

Mirëmëngjesi!	Mirëmëngjesi!
Mirëdita!	Mirëdita!
Ju bëftë mirë!	Faleminderit, urdhëroni të hamë!
Gëzuar!	Gëzuar!
Rruga e mbarë!	Mbarë paç!
Mirupafshim!	Mirupafshim!
Mirëmbrëma!	Mirëmbrëma!
Natën e mirë!	Natën e mirë!
Ju lutem!	Urdhëroni!
Ju lumtë!	Faleminderit!
Urdhëro!	Faleminderit!
Mirë se vini!	Mirë se ju gjej !
Më falni!	S'ka gjë!
Gëzuar ditëlindjen!	Faleminderit!

• Kuptojmë

Si e kalojnë kohën e lirë Zana dhe Iliri?
 Me çka i bëjnë ata detyrat e shtëpisë?
 Kur takohesh me shokë, cilën përshëndetje e thua?
 Si i përshëndet ti prindërit?
 Si e përshëndet mësuesen?

• Analizojmë.

Vërej figurat dhe thuaj: Cilat shprehje përdoren në këto raste?



Urdhë _____



Natën _____



Puna _____



Fa _____




Ju lu _____



Mirë _____

• Thellohemë. Shkruaj fjalët përshëndetëse sipas figurës.



3. Shkruaj disa fjalë përshëndetëse që ke mbajtur në mend. _____

Thuaj. A ka gjitha jonë ndonjë shprehje ndryshe nga ajo e vendit ku jeton.

11.

Në autobus

1. Flasim

Çfarë mjetesh udhëtimit janë këto?
Me çfarë mjeti udhëton ti më shumë?
Cilat mjete të udhëtimit janë më të padëmshme për mjedisin?



2. Lexojmë

Në autobus

Të mërkurën Nora e kishte pasditen të lirë. Ajo e pyeti babanë e saj se a mund të shkonte me të në punë. Ai pranoi me kënaqësi.

Babai i Norës është shofer autobusi në qytet. Nora u bë gati dhe shkoi me babanë e saj. Ajo u ul në karrigen e parë të autobusit. Ajo shihte se si babai e ngjet autobusin dhe si flet para mikrofonit.

Nora i shikonte makinat, kamionët, motoçikletat e bicikletat që lëviznin në rrugë. Babai i saj ishte i vëmendshëm. Ai shikonte kur zbrisnin dhe hipnin udhëtarët në autobus, pastaj shtypte butonin për mbylljen e derës. Ishte sidomos i kujdesshëm kur kishte gra me fëmijë në karrocë dhe pleq e plaka. Herë pas here e shikonte Norën dhe i buzëqeshte.

Nora u kënaq atë ditë me udhëtimin që bëri me autobus. Ajo ishte krenare që babai i saj është shofer autobusi.

Kuptojmë

1. Për çfarë e pyeti Nora babanë e saj?
2. Çka punon babai i Norës?
3. Pse u ul Nora në karrigen e parë?
4. Si ishte babai i Norës?
5. Kur ishte ai veçanërisht i kujdesshëm?

Analizojmë

Çka mendon ti, pse Nora ka shkuar me babanë e saj në punë?

Shkruaj disa fjali.

Thellohemë

Pse nganjëherë në qytet shpallet një ditë si ditë pa makina?

1. Shkruajmë

1. Shkruaj :Çka punojnë babai yt dhe nëna jote?.

2. Shkruaj: Çka dëshiron të bëhesh ti kur të rritesh?

2. Krahasime gjuhësore

Përkthe në gjuhën e vendit ku mëson këto fjalë

shofer - _____

ngas - _____

trafik - _____

i kujdeshshëm - _____

12.

Ëndërrimet e fëmijëve

1. Flasim.

Çka dëshiron të bëhesh ti kur të rrithesh?
Cila prej këtyre punëve të pëlqen më shumë? Pse?



2. Lexojmë

Ëndërrimet e fëmijëve

Mësuesja e shkollës shqipe u dha detyrë nxënësve që të tregonin se çka dëshirojnë të bëhen kur të rriten. Fëmijëve u pëlqeu kjo temë. Ata filluan të mendonin si ta paraqitnin profesionin që e ëndërrojnë.

Pas një çerek ore nxënësit ishin gati të prezantonin profesionet e tyre.

Genti ishte ulur pranë kompjuterit dhe po rregullonte shtëpizën e tij. Ai është specialist i informatikës.

Zana kishte veshur një mantel të bardhë dhe po kontrollonte një pacient. Ajo është infermiere.

Dritoni ishte veshur me tuta sportive dhe po luante me topin e futbollit. Ai është futbollist i famshëm.

Diana kishte një shkumës në dorë dhe po shkruante një fjali në dërrasë të zezë. Ajo është mësuese e re.

Ylli ka po rregullonte disa rroba ne rafte. Ajo është shitëse në një shtëpi të mallrave.

Edhe nxënësit e tjerë u prezantuan në profesionet e tyre.

Çfarë profesionesh kishin ata?

Shiko figurat dhe shkruaj çfarë profesionesh janë këto.

Kuptojmë

1. Çfarë detyre u dha mësuesja nxënësve? _____
2. Cili ishte profesioni i Gentit? _____
3. Po profesioni i Zanës cili ishte? _____
4. Çfarë kishte zgjedhur Diana? _____
5. Çfarë po bënte Yllka? _____

Analizojmë

1. Mjeku kontrollon _____
2. Mësuesi mëson _____
3. Kuzhinierja përgatit _____
4. Elektricisti rregullon _____
5. Muratori ndërton _____
6. Hidrauliku riparon _____
7. Kopshtari ujitet _____
8. Zdrukthëtari ndërton _____
9. Shitësi bën _____
10. Shoferi nget _____

3. Shkruajmë

Shkruaj tri profesione të cilat të pëlqejnë ty. Jep arsyе pse të pëlqejnë pikërisht këto.

4. Krahasime ndërkulturore

Fjalë të urta

Kush punon fiton.

Punën e sotme mos e lë për nesër.

Mundohu t'i përkthesh në gjuhën e vendit ku ti mëson këto dy fjalë të urta

PUNO SA ŃSHTË DITË

Ja edhe një fjalë tjetër e urtë për punën, e thënë me këngë. Këndojeni bashkë me mësuesin/en.

Puno sa ñshtë ditë

Shpejt

Pu - no sa ñsh - të di - të se na - ta po of - ron dhe
nuk
dje - li si ka - lo - rës po e - cëne - dhe shkon.
ka at - he - rë pu - në se di - ellipakndri - çon

13. Fatosi në spital

1. Flasim

Çka po sheh në këto pamje?



2. Lexojmë

Fatosi në spital

Një ditë Fatosi kishte lënduar këmbën duke luajtur futboll. Nëna e tij e dërgoi në spital. Në hyrje të spitalit një grua ua mori të dhënat dhe i drejtoi tek ortopedi.

Pasi e kontrolloi dhe i bëri radiografinë, mjeku ia mbështolli pjesën e poshtme të këmbës me gjips. Pastaj një infermiere e dërgoi në dhomën e të sëmurëve. Fatosi do të rrinte aty disa ditë.

Gjatë atyre ditëve Fatosi shikonte se si mjeku i kontrollonte të sëmurët. Motrat medicinale u jepnin të sëmurëve medikamente dhe ua matnin temperaturën. Pastruesja pastronte dyshemenë e dhomës. Kuzhinieri u sillte ushqimin në tavolinën afër krevatit. Fatosi nuk kishte ditur që në një spital punojnë aq shumë njerëz. Atij i pëlqeu shumë profesioni i mjekut. Kur të rritem do t'i shëroj të sëmurët, mendoi ai me vete.

Kuptojmë

Përgjigju pyetjeve

1. Çfarë i kishte ndodhur Fatosit? _____
2. Ku e dërgoi nëna e tij? _____
3. Çfarë i bëri mjeku? _____
4. Ku e dërguan Fatosin? _____
5. Çfarë bënte mjeku? _____

Analizojmë

Plotëso fjalitë

1. Kur sëmurem unë shkoj në _____
2. Kur mjeku më jep një recetë unë shkoj në _____
3. Kur kam temperaturë unë rri në _____
4. Kur nuk mund të shkoj në shkollë e lajmëroj _____
5. Unë e porosis shokun të më sjell _____

Thellohemi

Çka mendon ti pse i pëlqeu Fatosit profesioni i mjekut _____

3. Shkrueajmë

Çka bën ti kur sëmuresh? _____

4. Krahasime gjuhësore

Përkthe këto fjalë në gjuhën e vendit ku ti mëson

mjeku - _____

Infermierja - _____

pastruesja - _____

i/e sëmuri/a - _____

14.

Xhaxhi murator

- 1. Flasim.** Çfarë punësh bëjnë njerëzit në atdhe?
A është vështirë të kesh një punë në atdhe? Pse?
Po në vendin ku ti jeton si është?



2. Lexojmë

Xhaxhi murator

Dritoni ishte për pushimet e verës në Kosovë. Një ditë iu lut xhaxhait ta merrte me vete në punë. Xha Bardhi pranoi me kënaqësi. Ai është murator. Ata u nisën në mëngjes dhe pas një çerek ore arritën para një shtëpie gjysmë të ndërtuar. Xha Bardhi filloi nga puna. Ai vendoste tjegullat njërën mbi tjetrën. Dritoni i ndihmonte nganjëherë duke i sjellë mjete të ndryshme pune. Por ai u lodh shpejt.

Pas një kohe xhaxhai bëri një pushim. Dritoni e pyeti për punën e muratorit. Ai tha se punën e muratorit e bën me qejf. Është pak e rëndë, por me paratë që fiton mund të ushqejë familjen. Dhe kjo është me shumë rëndësi në Kosovë, sepse këtu ka papunësi. Shumë njerëz janë të varfër.

Atë ditë Dritoni ishte aq i lodhur, sa posa hëngri darkë e zuri gjumi menjëherë.

Kuptojmë

Përgjigju pyetjeve

1. Ku ishte Dritoni për pushimet e verës? _____
2. Çka iu lut ai xhaxhait? _____
3. Çka punonte xha Bardhi? _____
4. Çka bën xha Bardhi me paratë që fiton? _____
5. Pse e zuri gjumi Dritonin menjëherë? _____

Lidh fjalët me atë që i përgjigjet

- | | |
|-----------------|-------------------|
| 1. Muratori | bën operacione. |
| 2. Elektricisti | e ngjet trenin. |
| 3. Mjeku | ndërtion murin. |
| 4. Automekaniku | shpjegon mësimin. |
| 5. Shoferi | rregullon rrymën. |
| 6. Mësuesi | riparon makinën. |

Analizojmë

1. Shkruaj pse në atdhe ka njerëz të varfër? _____

Thellohemë

1. Çka mendon ti pse emigrojnë shumë njerëz në vende të tjera? _____

2. Pyeti prindërit e tu se çka kanë punuar para se të shkonin në mërgim _____

3. Shkruajmë

Përgjigju pyetjeve të mëposhtme:

1. Pse Dritoni shkoi me xhaxhain e tij në punë. Çka mendon ti çfarë dëshironte ai? _____
3. Përkthe fjalët në gjuhën e vendit ku mëson

I varfër - _____

Papunësi - _____

15.

Ndihmojmë prindërit

1. Flasim Çka po sheh në këto pamje?

Çka bëjnë fëmijët në familje?

Cilën punë e bën ti në familje rregullisht?



2. Lexojmë

Ndihmojmë prindërit

Gjergji dhe Nora janë vëlla e motër. Kur u kthyen nga shkolla, pasi pushuan pak, i bënë detyrat. Më vonë Nora mori letrat, që babai i saj i kishte bërë gati dhe i dërgoi në postë. Gjergji filloi t'i ndihmonte nënës për të përgatitur darkën. Ai qëroi disa patate dhe i vendosi në enë për t'i zier. Pastaj mori lugët, pirunët e thikat dhe i vuri mbi tryezën e bukës. Pas pak, babai i Gjergjit, Andi, do të kthehej nga puna. Ai është kopshtar. Nëna e Gjergjit, Diana, është kuzhiniere shumë e mirë. Ajo përgatit gjellë të shijshme. Ajo gjëzohet fort kur sheh Gjergjin si i ndihmon në kuzhinë.

Duke ngrënë darkë, Andi tha se patatet ishin të shijshme.

-Unë i kam qëruar baba, - tha Gjergji krenar.

Nora e shikoi vëllanë dhe iu drejtua babait:

-Edhe unë kam dërguar letrat e tua në postë, - tha ajo.

Sot të gjithë paskemi punuar. Prandaj darka ka shije edhe më shumë, -tha ai me gjëzim në fytyrë.

Kuptojmë

1. Çka bënë Gjergji dhe Nora pasi u kthyen nga shkolla? _____

2. Ku shkoi Nora? _____
3. Çka i ndihmoi Gjergji nënës? _____
4. Si janë gjellët që përgatit Diana? _____
5. Cili është profesioni i Andit? _____
6. Pse darka ishte më e shijshme? _____

Analizojmë

1. Çka mendon ti pse Gjergji dhe Nora u ndihmojnë prindërve? _____

2. Çfarë ndihmon ti në shtëpi? _____

Thellohemë

Shkruaj cilat janë profesionet e prindërve të tu.

Bëj një intervistë me ta dhe shkruaj përgjigjet e tyre. Përdor shprehjet si:

Cili është profesioni yt?

Çfarë profesioni ke mësuar në shkollë?

Ku punon ti?

A të pëlqen puna që bën?

Mendo vetë edhe ndonjë pyetje tjetër.

Gjej ndonjë fotografi të prindërve duke punuar dhe ngjiti në fletoren tënde.

Punë të mbarë!

3. Shkruajmë

Shkruaj aktivitetet që ti i bën gjatë një dite.

(*Në mëngjes... Në drekë... Në darkë...*) _

Paradite	Gjatë mesditës	Pasdite

4. Përkthe në gjuhën e vendit ku ti mëson këto fjalë:

Bëj detyrat - _____

Ndihmoj prindërit - _____

Darkë e shijshme - _____

Këndojmë

PËR NJË ORË

Lili është një djalë shumë punëtor. Vetëm për një orë ai mundi të bëjë aq shumë punë sa nuk e besoni. Për të mësuar çfarë bëri ai vetëm për një orë këndoni këtë këngë të bukur.

Allegretto

The musical score consists of three staves of music in common time (indicated by '4') and G clef. The first staff starts with a dynamic 'mp'. The lyrics are:

Për një o - rë Li - li e - dhe shokt' e tij mblo - dhën sot në a - rë

The second staff continues the melody and lyrics:

një thes me ka - llinj. Ve - tëm për një o - rë sot ka - na - li n'fshat

The third staff concludes the melody with two endings:

1. u bë më i gjë - rë 2. u bë më i gjat'. u bë më i gjaf.

Vetëm për një orë
Drita me vëllanë,
i shkurtuan drutë
ndihmuani maman'.

Ref.

Vetëm për një orë...

Shihni dhe dëgjoni
o fëmij' gazmor',
sa shum mund të bëhet
vetëm për një or'.

Ref.

Vetëm për një orë...

16. Në ekipin e futbollit

1. Flasim Çfarë aktivitetesh sportive janë këto?
Cili aktivitet të pëlqen ty më shumë? Sa lloje të sporteve njeh?



2. Lexojmë

Në ekipin e futbollit

Dardani është nxënës i klasës së dytë. Atij i pëlqen shumë futbolli. Dy herë në javë shkon në ekipin e fëmijëve për të ushtruar. Aty ka njojur disa fëmijë të tjera shqiptarë, si dhe italianë, zviceranë, anglezë etj. Trajneri i mëson jo vetëm që të luajnë bukur, por edhe të kenë kujdes të mos e lëndojnë njëri-tjetrin.

Kur Dardani luan në ndonjë ndeshje, prindërit e tij vijnë shpesh ta shohin. Kur jep gol, gëzohet fort dhe vrapon deri tek ata për t'i përqafuar.

Ai ëndërron që kur të rritet do të luajë në ndonjë ekip të njojur të futbollit.



Kuptojmë

1. Në cilën klasë është Dardani?
2. Cili sport i pëlqen atij?
3. Çka i mëson trajneri?
4. Kush vjen për ta parë Dardanin kur luan?
5. Çka ëndërron ai?

Analizojmë

Ti ke dëshirë të paraqitesh në një ekip sportiv.

Shkruaj çka duhet të bësh që të paraqitesh.

Mund të përdorësh këto pyetje: Si quhet klub? Kush është përgjegjës?

Çfarë numri të telefonit ka? Sa kushton?

Thellohemë

Pyet shokët dhe shoqet e klasës se çka bëjnë gjatë kohës së lirë.

Shënoji në tabelën e mëposhtme

...Artani me familjen e tij gjatë kohës së lirë	Bën shëtitje...	Sa shpesh?
Iliri me shokët e tij	Luajnë futboll....	

1. Shkruajmë

1. Çka bën ti me qejf kur ke kohë të lirë? _____

2. Shkruaj çfarë do të bësh diçka të re? _____

2. Përkthe në gjuhën e vendit ku ti mëson këto fjalë:

1. Ekip futbolli - _____ 2. Ëndërroj - _____

17.

Në bibliotekën e qytetit

- 1. Flasim** Çka po sheh në këto fotografi?
Çka lexon më me dëshirë?



- 2. Lexojmë**

Në bibliotekën e qytetit

Petriti dhe Zana janë nxënës të klasës së tretë. Hobi i tyre është leximi. Petritit i pëlqen sidomos libri i rekordeve të Ginisit si dhe librat për kafshët e egra. Zana ka lexuar një libër të ilustruar pér vullkanet. Ajo dëshiron që të vizitojë një vend ku mund të shohë nga afér një vullkan.

Një herë në javë Zana dhe Petriti shkojnë në bibliotekën e qytetit. Aty ka aq shumë libra, revista, filma të ndryshëm sa ata harrojnë të kthehen me kohë në shtëpi. Ata janë habitur kur kanë parë në një raft edhe libra në gjuhën shqipe. Herë pas here ata marrin edhe libra shqip. Bibliotekarja i shikon me ëmbëlsi dhe i regjistron librat që ata i huazojnë. Ata përshëndesin bibliotekisten dhe kthehen në shtëpi.



• Kuptojmë

1. Në cilën klasë janë Petriti dhe Zana? _____
2. Cili libër i pëlqen Petritit? _____
3. Po Zana cilin libër e ka lexuar? _____
4. Ku shkojnë ata një herë në javë? _____
5. Çfarë kanë parë ata në një raft? _____
6. Çfarë marrin ata herë pas here? _____

• Analizojmë

Shkruaj cili libër të ka pëlqyer më shumë ty? _____

A ke lexuar ndonjë libër në gjuhën shqipe? Nëse po, kush e ka shkruar dhe si e ka titullin? _____

Si quhet ai/ajo që shkruan një libër? _____

Thellohemë

Bëj një intervistë me shokun/shoqen e klasës lidhur me leximin.

Shëno në fletore a lexon ai/ajo me dëshirë, sa libra ka lexuar, cilët libra i pëlqejnë më shumë etj.

Kur të kesh mbaruar prezantoje intervistën para klasës.

3. Shkruajmë

Shiko fotot dhe shkruaj se çfarë po bëjnë këta fëmijë?





4. Përkthe në gjuhën e vendit ku ti mëson këto fjalë:

Vizitoj - _____

Huazoj - _____

Habitem - _____

Këndojmë

LIBRAT RADHË - RADHË

Ja dhe një këngë e bukur për librat e radhitur në raftet e bibliotekës.

Këndoje duke duartrokitur:

didaktike

The musical notation consists of a single staff in common time (indicated by '2'). It features a treble clef and a key signature of one sharp (F#). The notes are primarily quarter notes and eighth notes, with some sixteenth-note patterns. The lyrics are written below the staff: 'Li-brat rri-në rra-dhë rra-dhë, pre-sin do-rën që t'i marrë'. The word 'didaktike' is written above the staff to the right of the last note.

Li-brat rri-në rra-dhë rra-dhë, pre-sin do-rën që t'i marrë
Sa fi-gu-ra, sa tre-gi-me, do të hyjn'në bo-tën ti-me

The musical notation consists of a single staff in common time (indicated by '2'). It features a treble clef and a key signature of one sharp (F#). The notes are primarily quarter notes and eighth notes. The lyrics are written below the staff: 'Pre-sin do-rën t'i shfle-to-jë, pre-sin sy-rin t'i le-xo-jë'.

Li-brat rri-në krah për krah, tash ci-li va-lë ra-dhën e ka

The musical notation consists of a single staff in common time (indicated by '2'). It features a treble clef and a key signature of one sharp (F#). The notes are primarily quarter notes and eighth notes. The lyrics are written below the staff: 'Sa përra-lla rrin' a-ty, e-ja t'i kën-dojm'të dy'.

Thoti pa-ri: merr-më mu', siç më do dhe un' të du.

18.

Para ekranit të televizorit

1. Flasim

Çka po sheh në këto fotografi?

A të pëlqen të rrish para televizorit?

Apo më shumë ke dëshirë të luash ndonjë lojë në kompjuter?



2. Lexojmë

Para ekranit të televizorit

Rinori një ditë erdhi me vonesë në shkollën shqipe. Kur mësuesi e pyeti përvonesën ai tha se kishte shikuar një film në televizor. Ishte habitur aq shumë pas filmit sa kishte harruar që ka shqip pasdite.

- Sa minuta e shikon televizorin gjatë ditës?- e pyeti mësuesi Rinorin.
- Një orë e gjysmë, mësues, nganjëherë edhe dy orë,- u përgjigj Rinori.
- Uuuuuuu,- u dëgjua një murmurimë në klasë.
- Unë mund ta shikoj televizorin vetëm gjysmë ore në ditë, - tha Nora,
- Po ti Petrit?,-pyeti mësuesi.
- Unë guxoj deri në një orë të rri para televizorit,- tha ai.
- Mua nëna më thotë që më mirë është të lexoj një libër se të shoh televizor,
- tha Monda.

Rinori e mori përgjigjen nga mësuesi e nxënësit pa pasur nevojë të qortohej.

- Nuk do të shikoj më televizor gjatë pushimit të drekës, - i tha ai Valbonës.

• Kuptojmë

1. Pse erdhi me vonesë Rinori në mësimin shqip? _____

2. Sa gjatë e shikon Rinori televizorin gjatë ditës? _____

3. Po Nora sa kohë kalon para televizorit? _____

4. Çka i thotë nëna Mondës? _____

5. Çfarë vendimi mori Rinori? _____

• Analizojmë

1. A shikon ti edhe programet televizive në gjuhën shqipe? _____

2. Sa kohë shikon ti televizorin gjatë një dite? _____

3. Çka mëson ti nga televizori? _____

• Thellohemë

Bisedo me shokun/ shoqen e bankës se çka shikon ai/ajo më me qejf në televizor. Shëno informacionet që ai/ajo t'i jep _____

Shkruajmë

Shkruaj për një emision televiziv apo për një film të vizatuar etj., që ty të pëlqen shumë. Pse ty të pëlqen? Për çka bëhet fjalë aty? _____

4. Përkthe këto fjalë e shprehje në gjuhën e vendit ku ti mëson:

Vonesë - _____

Shikoj televizorin - _____

Përgjigje - _____

Qortoj - _____

Këndojmë

BOTA NË INTERNET

Përveç televizorit, sot fëmijët e kalojnë kohën edhe pranë kompjuterit duke përdorur internetin. Një fëmijë përmes kësaj kënge na tregon përfshirje të përdor ai internetin. Këndoni bashkë me të!

Vivo

Sa her' që u - lem un' pran' tij' men - doj

Se she - sis në për gji - thë - si gji - thë - si

Ref.

Shfle - toj më nga - da _____ lë fa - qet n'in - ter - net



Le - xoj me ku - rre - shtje ndo - dhit e she - ku - llit.

19.

Vizitë në kopshtin zoologjik

1. Flasim

Cilat kafshë janë këto?
Ku jetojnë këto kafshë?
Cili është dallimi mes qenit dhe ujkut?



2. Lexojmë

Vizitë në kopshtin zoologjik

Mësuesi i shkollës shqipe një ditë na tha që do të vizitojmë kopshtin zoologjik. Ne u gjembi shumë dhe mezi prisnim të shihnim kafshët e ndryshme. Të shtunën në orën dhjetë ne ishim para kopshtit zoologjik. Pasi morëm biletën hyrëse ne u gjendëm brenda. Për gati dy orë ne vizituam tërë kafshët e kopshtit. Pastaj bëmë një pushim të vogël. Më vonë mësues Agimi na tha të zgjedhim një kafshë që na pëlqen e ta vizatojmë. Iliri zgjodhi elefantin, Zana u afrua afër gjirafës, Liridoni e pëlqeu luanin, kurse unë vizatova një ari të vogël. Atë ditë të gjithë nxënësit vizatuan kafshën e tyre të dashur.

Pastaj punimet tona i ekspozuam në shkollen shqipe dhe i vendosëm në murin e klasës.

Klasa u bë më e bukur me punimet tona.



• **Kuptojmë**

1. Çka tha mësuesi i gjuhës shqipe? _____
2. Kur shkuan nxënësit në kopshtin zoologjik? _____
3. Çka bënë nxënësit pas pauzës? _____
4. Çka vizatuan Iliri e Liridoni? _____
5. Ku i vendosën nxënësit punimet? _____

• **Analizojmë**

Cila kafshë të pëlqen? _____
Pse të pëlqen kjo kafshë? _____
A ke ndonjë kafshë në shtëpi? _____

• **Thellohemë**

Çfarë kafshësh ke parë te të afërmit e tu në Atdhe? _____

3. Shkruajmë

Shkruaj emrat e disa kafshëve shtëpiake _____

Përmendi disa kafshë të egra. Cilat prej kafshëve të egra janë të rrezikshme?

Vizato kafshën që të pëlqen ty

4. Përkthe në gjuhën e vendit ku ti mëson këto fjalë:

Kopsht zoologjik _____ Biletë hyrëse _____ Vizitoj _____

20.

Vizitë te daja

1. Flasim Çka po sheh në këto fotografi?

Çka bëjnë fëmijët? Po ti çfarë bën gjatë kohës së lirë?



2. Lexojmë

Vizitë te daja

Valbona me prindërit e saj vizituan dajën. Ai jeton në një qytezë tridhjetë kilometra larg tyre. Ata udhëtuan me tren. Valbona u kënaq duke shikuar nga dritarja bukuritë natyrore. Ajo bëri edhe disa foto. Daja i saj u gëzua shumë kur i pa. Valbona iu hodh ne qafë dhe e përqafoi fort. Edhe Djella, vajza e dajës, fluturonte nga gëzimi. Ajo mori Valbonën për dore dhe i tregoi disa libra dhe lodra që i kishte blerë.

Në drekë u ulën të gjithë rreth tryezës për të ngrënë. Tezja kishte gatuar një pite të shijshme.

Pasdreke të gjithë shkuan te lijeni për të bërë një udhëtim me anije. Ata u kënaqën me bukuritë e liqenit dhe me bisedat që bënë.

Para se të ndaheshin Valbona iu lut dajës që t'i viziton. Daja i saj i premtoi se pas dy javësh do t'i vizitojë bashkë me familjen. Djella i tha se do të komunikojnë përmes mesazheve. Duke u kthyer në shtëpi, Valbona ishte e lumtur që ka dajën afér qytetit të saj.

• Kuptojmë

1. Ku shkoi Valbona me prindërit e saj? _____
2. Çka bëri ajo gjatë udhëtimit? _____
3. Çka i tregoi Djella Valbonës? _____
4. Çka kishte gatuar tezja? _____
5. Ku shkuan pasdreke ata? _____
6. Si u ndie Valbona duke u kthyer në shtëpi? _____

• **Analizojmë**

1. A ka familja jote të afërm në vendin ku jetoni? _____

2. Ku shkoni ju për vizitë? _____

3. Ku të pëlqen ty të shkosh për vizitë? _____

• **Thellohemi**

4. Po kur jeni për pushime në atdhe kë e viziton? _____

5. Kush të pëlqen më shumë prej farefisit tënd në atdhe dhe pse? _____

3. Shkruajmë

Shkruaj për një vizitë te farefisi yt. _____

4. Përkthe në gjuhën e vendit ku ti mëson këto fjalë:

mikpritja - _____

gatuaj - _____

premtoj - _____

i/elumtur - _____

21.

Video lojërat

1. Flasim Çka po sheh në këto fotografi?
A ke dëshirë të luash video lojëra? Pse?



2. Lexojmë

Video lojërat

Arlindi dhe Genti, kur kanë kohë të lirë, luajnë lojëra të ndryshme. Babai u ka blerë atyre një aparat i cili quhet Playstation 4 dhe disa lojëra për moshën e tyre. Babai u ka thënë që ata mund të luajnë vetëm nga një gjysmë ore në ditë.

Nganjëherë Dardani e Genti janë aq të dhënë pas lojës sa harrojnë të shikojnë orën. Nëna e tyre i qorton dhe ata detyrohen të ndërpresin lojën.

Por një ditë babai ka bërë një marrëveshje interesante me ta. Ai u ka thënë se, nëse luajnë vetëm nga gjysmë ore në ditë, pas tre muajsh do të kenë një lojë të re. Kështu, Dardani dhe Genti tash luajnë nga gjysmë ore dhe gëzohen që do të kenë një lojë të re.

Kuptojmë

1. Çka bëjnë Arlindi dhe Dardani gjatë kohës së lirë? _____
2. Çka u ka blerë atyre babai? _____
3. Pse i qorton nëna? _____
4. Cila ishte marrëveshja që bëri babai me ta? _____

• Analizojmë

1. A ke ti një video lojë? _____
2. Cila prej lojërave që i luan të pëlqen më shumë? _____

• Thellohemë

1. Pse thuhet se të kalosh shumë kohë duke luajtur me video lojëra
është e dëmshme? _____

3. Shkruajmë

Përshkruaj se çka ndodh në lojën që të pëlqen më shumë? _____

Vizato si duket një lojë që të pëlqen

4. Përkthe fjalët në gjuhën e vendit ku mëson

video lojë - _____ ndërpres - _____

marrëveshje - _____ gëzohem - _____

Nexhat Maloku, Nexhmije Mehmetaj
PUNA DHE KOHA E LIRË
Fletore tematike

Botimi i parë

Botues:
Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:
Agim Lluka

Redaktor teknik:
Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje
Formati: 205x285

U shtyp në shtator 2010
në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë
www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

379.8 (076.1)

Maloku, Nexhat

Fletore tematike: puna dhe koha e lirë: për nivelin e parë/
Nexhat Maloku, Nexhmije Mehmetaj. -Pejë:
Dukagjini, 2010. - 64 f. ilustr. me ngjyra; 30 cm.

1. Mehmetaj, Nexhmije

ISBN: 978-9951-05-237-5

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 296/2, të datës 22.06.2010*